

## Përgjatë njëzet vjetëve po e pres pavarësinë e Kosovës

Interviste ekskluzive për kombëtaren “Bota Sot” me albanologun e njohur Robert Elsie (1).

Me albanologun e njohur Robert Elsie takohemi në Prishtinë. Ai ishte për një vizitë disaditore në Kosovë. Në intervistën ekskluzive për gazetën kombëtare “Bota Sot,” dr. Elsie flet për Ditën e Madhe të Pavarësisë, studimet albanologjike sot, për thyerjet e mëdha jo vetëm të mureve kulturore, projektet që do të botojë së afërmi, etj.

[BS]: Gjatë njëzet vjetëve të fundit jeni njohur me botën shqiptare që nga viti 1978 në Shqipëri dhe një vit më vonë edhe në Kosovë, në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare. Edhe në këtë javë që jeni këtu, a keni diçka të veçantë që mund të na thoni?

[RE]: Unë mund t’ju them se përgjatë njëzet vjetëve po e pres Pavarësinë e Kosovës. Dhe tani po e shoh se po realizohet kjo pavarësi e merituar dhe jam shumë, shumë i lumtur. Do të jem akoma më i lumtur në javën tjetër nëse shpallet Pavarësia. Ky do të jetë gëzim i madh për mua.

[BS]: Ju nuk do të jeni këtu?

[RE]: Jo, nuk do të jem këtu, por do të jem pranë jush.

[BS]: Keni studiuar filologjinë klasike, gjuhësinë në përgjithësi. Keni bërë studime në qendrat e mëdha, qoftë në Berlinin perëndimor, Paris, Dublin, Bon. Me gjithë këtë përvojë nëpër qendra të mëdha, si i shihni sot studimet albanologjike në përgjithësi?

[RE]: Them se në fushën e albanologjisë ka ende shumë për t’u bërë. Bile edhe veprat, hapat themelore ende nuk janë bërë në fushën e shkencës albanologjike dhe është për të ardhur keq që ajo është lënë mënjanë në këtë mënyrë! Shoh në qendrat e albanologjisë, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë, se nuk punojnë si duhet të punojnë. Po të shikoni institutin në Tiranë apo në Prishtinë, shihet që nuk punohet shumë, për kushtet financiare. Kushtet ekonomike kryesisht janë problemi sepse albanologjia nuk financohet. Në vendet e varfëra natyrisht parat shkojnë në drejtime të ndryshme, por fusha e kulturës dhe shkencës lihet mënjanë. Për këtë arsye shkencëtarët nuk mund të punojnë. Prandaj them se ende ka për t’u bërë në fushën e albanologjisë.

[BS]: A është vetëm natyra financiare e mospunës e moskontributit të studiuesve të ndryshëm?

[RE]: Fondet janë bazë themelore të shkencës. Njerëzit duhet të jetojnë, dhe nëse nuk jetojnë nga shkenca, detyrimisht do të merren me diçka tjetër. të përqendrohen në fushën e tyre. Ka shkencëtarë të mirë. Një fakt tjetër që ka penguar ecurinë e albanologjisë është izolimi i botës shqiptare nga Evropa dhe bota. Së pari izolimi tradicional i Shqipërisë, gjithashtu izolimi i Kosovës në kohën e Serbisë dhe probleme të kontaktit me botën. Tani janë kapërcyer këto gjëra, por edhe gjatë viteve të fundit izolimi ka bërë që shkencëtarët nuk ishin në dijeni për zhvillimin e shkencës në botën perëndimore. Nuk kishin kontakte, nuk kishin udhëtuar, nuk kishin studiuar jashtë. Kishin mbetur midis tyre, dhe janë krijuar shumë mite, shumë shtrembërime, veçanërisht në fushën e historisë shqiptare. Mitet që përsëriten shpesh, ca që

bëhen të vërteta, dhe njerëzit nuk ballafaqohen me mendimet e tjera.

[BS]: Ishit në Shqipëri edhe në kohën e monizmit. Përgjatë 20 vjetëve në botën shqiptare ndryshoi gjithçka. Jetuat edhe në Berlinin perëndimor. Bashkimi dhe thyerja e atij muri. Si e shihni murin shqiptar sot?

[RE]: Muri shqiptar besoj se është vetëm në trurin e shqiptarëve, pikërisht siç thuhet se muri i Berlinit mbetet vetëm në trurin e gjermanëve. Është shumë interesante se gjermanët e mbajnë murin ende në tru, edhe pse kanë kaluar shumë vjet të bashkimit të Gjermanisë. Edhe shqiptarët e kanë atë, ende një mur por vetëm në tru. Besoj se me Pavarësinë e Kosovës dhe, para së gjithash, me ndërtimin e rrugës Durrës-Morinë-Prizren, çdo gjë do të ndryshojë shpejt. Shqiptarët do të bashkohen. Do të krijohet një njësi kulturore. Nuk dihet nëse do të krijohet një njësi shtetërore, por kjo nuk ka rëndësi kjo sepse kufiri është diçka që edhe kalohet.

[BS]: Thoni do të bashkohen?

[RE]: Po. Po bashkohen tani.

[BS]: Do të thotë nuk paska qenë e bashkuar edhe në aspektin kulturor?

[RE]: Jo, nuk besoj! Nuk ka qenë fare e bashkuar. Për shqiptarët e Shqipërisë, Kosova ka qenë krejtësisht e panjohur. Nuk janë të interesuar. Edhe sot nuk janë të interesuar për Kosovën në fushën e kulturës. Më përpara s'e kanë njohur kulturën e Kosovës. Ishin më afër me Kinën, me Italinë sesa me Kosovën. Mbretërojnë edhe mospërfillje ndaj Kosovës. Mungesë njohurive. Shumica e shqiptarëve të Shqipërisë nuk kanë qenë në Kosovë. Por tani, me ndërtimin e rrugës, do të vijjnë. Po vijjnë shqiptarët. Njihen me njeri-tjetrin. Por është një proces që edhe kërkon njëfarë kohe.

Bashkëbisedoi: Enver S. Morina.

[botuar në / *Bota Sot*, Prishtinë, 14 shkurt 2008, f. 7 / published in: *Bota Sot*, Prishtina, 14 February 2008, p. 7.]